



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

RREGULLORE

PËR

“MËNYRËN, AFATET DHE PROCEDURËN E PAGESËS SË PENSIONIT
PRIVAT”

Miratuar me Vendim Bordi nr. 191, datë 01.11.2024

Neni 1

Objekti

Kjo rregullore ka për objekt përcaktimin e mënyrës, afateve dhe procedurës për marrjen e pagesës së pensionit privat, në llogarinë e anëtarit të fondit të pensionit, pasi ka i lindur e drejta e pagesës së pensionit, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 2

Baza ligjore

Kjo rregullore hartohet në zbatim të nenit 14, pika 2, të ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar dhe të nenit 73, pika 5, të ligjit nr. 76/2023 “Për Fondet e Pensionit Privat”.

Neni 3

Përkufizime

1. Në këtë rregullore termat e mëposhtëm kanë kuptimin si vijon:

- a. **“Pagesë e menjëhershme”** është pagesa e plotë apo e pjesëshme në para e kuotave që gjenden në llogarinë e anëtarit të fondit, sipas kërkesës së tij, të vlerësuara me çmimin e ditës së depozitimit të kërkesës për tërheqje.
- b. **“Pagesë periodike pensioni”** është pagesa periodike mujore në para, në formë pensioni, të kuotave që gjenden në llogarinë e anëtarit të fondit, të shtrira në kohë, sipas kontratës së nënshkruar ndërmjet anëtarit të fondit të pensionit dhe shoqërisë administruese të fondit të pensionit privat.

2. Termat e tjerë të përdorur në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me ato të parashikuara në ligjin nr. 76/2023 “Për Fondet e Pensionit Privat”, këtu e në vijim “Ligji”.

Neni 4 **Fusha e zbatimit**

Kjo rregullore zbatohet nga shoqëritë administruese të fondeve të pensionit privat, të licencuara nga Autoriteti, për të gjitha procedurat e llogaritjes dhe marrjes së pagesave të pensionit privat nga anëtari i fondit të pensioni, pas plotësimit të kushteve sipas legjisllacionit në fuqi.

Neni 5 **Mënyrat e pagesave të pensionit privat**

1. Anëtari i fondit të pensionit privat gëzon të drejtën e përdorimit të vlerës neto të aktiveve në llogarinë e tij, pas përmbushjes së kushteve të përcaktuara në pikën 1, të nenit 73, të Ligjit.
2. Anëtari i fondit të pensionit privat ka të drejtë të marrë dhe/ose përdorë vlerën neto të aktiveve në llogarinë e tij të pensionit, sipas mënyrave të mëposhtme:
 - a. marrjen e pagesës së menjëhershme, sipas kërkesës drejtuar shoqërisë administruese të fondit të pensionit privat;
 - b. marrjen e pagesave periodike mujore në formë pensioni të shtrira në kohë;
 - c. përdorimin e vlerës neto të aktiveve për blerjen e një kontrate të sigurimit të jetës në formë “anuiteti”, tek një shoqëri sigurimi jete;
 - ç. kombinimin e mënyrave të cituara në shkronjat “a”, “b”, dhe “c”, të këtij neni.
3. Sipas mënyrës të zgjedhjes së marrjes së pagesës së pensionit, anëtari i fondit të pensionit nënshkruan kontratë me shoqërinë administruese në rastin e parashikuar në shkronjën “b”, të pikës 2, të këtij neni, ose paraqet kërkesë pranë shoqërisë administruese në rastin e parashikuar në shkronjat “a” dhe “c” të pikës 2, të këtij neni.
4. Anëtari i fondit të pensionit që ka ushtruar të drejtën të marrë dhe/ose të përdorë vlerën neto të aktiveve në llogarinë e tij të pensionit, sipas përcaktimeve të pikës 2, të këtij neni, nuk mund të vijojë të derdhë kontribute në atë fond pensioni.

Neni 6 **Detyrimi për informim**

1. E drejta e pakushtëzuar e anëtarit të fondit për marrjen e pagesës së pensionit nga llogaria e tij e pensionit privat, pas përmbushjes së kushteve të pikës 1, të nenit 73, të Ligjit, duhet të jetë e shkruar qartë në kontratën dhe prospektin e fondit të pensionit privat.
2. Shoqëria administruese e fondit të pensionit privat, duhet të informojë anëtarin e fondit të pensionit mbi vlerësimin aktual të llogarisë individuale, opsionet mbi mënyrat e pagesës së pensionit, si dhe t’i japë udhëzime mbi zbatimin e çdo mënyre pagese, 3 muaj përpara se anëtari të arrijë moshën për marrjen e pagesave të pensionit, sipas përcaktimeve të pikës 1, të nenit 73, të Ligjit.

3. Informimi i anëtarit sipas përcaktimeve në pikën 2, të këtij neni, bëhet në formë të shkruar, me shkresë, në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme për anëtarin apo në formë elektronike përmes një adrese aktive e-mail, apo mesazh. Në çdo rast, shoqëria administruese duhet të sigurohet se njoftimi është bërë në adresat e përditësuara nga anëtari i fondit të pensionit privat.

Neni 7

Pagesa e menjëhershme e vlerës neto të aktiveve të pensionit

1. Me lindjen e të drejtës së marrjes së pagesës së pensionit, anëtari i fondit të pensionit mund të zgjedhë të marrë vlerën neto të aktiveve në llogarinë e tij në formën e pagesës së menjëhershme.
2. Pagesa e menjëhershme mund të jetë:
 - a) pagesë e plotë e vlerës neto të aktiveve në llogarinë e anëtarit,
 - b) pagesë e pjesshme e vlerës neto të aktiveve.
3. Anëtari i fondit të pensionit i cili kërkon të ushtrojë të drejtën e tij sipas parashikimeve të pikës 2, të këtij neni, i drejtohet shoqërisë administruese me një kërkesë. Shoqëria administruese transferon shumën e vlerës neto të aktiveve të llogarisë së anëtarit në llogarinë bankare të tij, brenda 15 ditëve pune nga data e depozitimit të kërkesës nga anëtari.
4. Në rastin e parashikuar në shkronjën “b” të pikës 2, të këtij neni, aktivet e mbetura të anëtarit në llogarinë e pensionit, investohen në të njëjtën mënyrë si të gjitha aktivet e fondit të pensionit privat.
5. Pagesat në para, sipas parashikimeve të pikës 3, të këtij neni, të kuotave që gjenden në llogarinë e anëtarit të fondit të pensionit, vlerësohen me çmimin e kuotës të ditës së depozitimit të kërkesës së anëtarit për tërheqje të menjëhershme.

Neni 8

Pagesat periodike mujore të pensionit privat

1. Me lindjen e të drejtës së marrjes së pagesës, anëtari i fondit të pensionit mund të zgjedhë të marrë pagesa periodike mujore, në formë pensioni, në para, të kuotave që gjenden në llogarinë e tij.
2. Anëtari i fondit të pensionit privat dhe shoqëria administruese e fondit të pensionit privat nënshkruajnë një kontratë ndërmjet tyre për mënyrën, përcaktimin e pagesave periodike mujore, si dhe të drejtat dhe detyrimet e palëve. Kontrata duhet të përmbajë të paktën:
 - a) shumën e pagesës periodike mujore (përcaktuar në para ose kuota);
 - b) të drejtën e anëtarit të fondit të ndryshojë masën e pagesës periodike mujore;
 - c) datën e njohjes së detyrimit për pagesën periodike të pensionit;
 - d) detyrimin e shoqërisë administruese për dërgimin e urdhër pagesës brenda 3 ditëve pune, nga data e njohjes së detyrimit, për ekzekutimin e pagesës;

- e) trajtimin tatimor për pagesat periodike mujore sipas legjislacionit në fuqi;
 - f) penalitetin në rast të vonesës së pagesave nga shoqëria administruese;
3. Shoqëria administruese e fondit të pensionit privat transferon pagesat mujore në llogarinë bankare të caktuar nga përfituesi i pensionit.
 4. Kontrata për mënyrën dhe përcaktimin e pagesave periodike mujore nënshkruhet brenda 15 ditëve pune nga data e depozitimit të kërkesës nga anëtari.
 5. Aktivitetet e mbetura të anëtarit në llogarinë e pensionit, pas çdo pagese periodike, investohen në të njëjtën mënyrë si të gjitha aktivitetet e fondit të pensionit privat.
 6. Pagesat periodike mujore, në para, të kuotave që gjenden në llogarinë individuale të anëtarit vlerësohen me çmimin e kuotës të ditës së njohjes së detyrimit të përcaktuar në kontratën e nënshkruar mes palëve.

Neni 9

Blerja e një kontrate të sigurimit të jetës në formë “anuiteti”

1. Kur anëtari i fondit të pensionit privat zgjedh të përdorë vlerën neto të aktiveve për blerjen e një kontrate të sigurimit të jetës në formë “anuiteti” tek një shoqëri sigurimi jete, ai lidh kontratë me shoqërinë e përzgjedhur të sigurimit të jetës.
2. Shoqëria administruese transferon vlerën neto të aktiveve për blerjen e një kontrate të sigurimit të jetës tek shoqëria e sigurimit, brenda 15 ditëve pune nga data e depozitimit të kërkesës nga anëtari.
3. Kontrata e sigurimit të jetës në formë “anuiteti” mund të jetë:
 - a. “anuitet” i përjetshëm, që nënkupton pagesa përfitimi periodike deri në vdekjen e të siguarit;
 - b. “anuitet” me afat të përcaktuar dhe në vijim të përjetshme, që nënkupton pagesa përfitimi që kryhen brenda një periudhe të caktuar kohe për të siguarin, ose për përfituesit në rast të vdekjes së të siguarit. Në përfundim të afatit të përcaktuar anuiteti bëhet i përjetshëm nëse i siguarit është ende gjallë dhe përfundon nëse ndërkohë ai ka ndërruar jetë;
 - c. “anuitet” i përbashkët, që nënkupton pagesa periodike të cilat, me vdekjen e njërit nga të siguarit, vazhdojnë t’i kryhen të siguarit tjetër dhe me vdekjen e këtij të fundit, trashëgimtarit ligjor/përfituesit të përcaktuar në kontratë;
 - d. “anuitet” i kthyesëm, që nënkupton pagesa periodike për të siguarin deri sa jeton, në vijim shumë e mbetur i paguhet përfituesit të përcaktuar në kontratë nëse ky i fundit jeton. Anuiteti përfundon me vdekjen e përfituesit;
 - e. forma të tjera “anuiteti” të ofruara nga shoqëria e sigurimit.
4. Modalitetet e pagesave periodike, koha e fillimit, përfundimit të pagesave dhe çështje të tjera të ngjashme do të përcaktohen në kontratën e sigurimit.

Neni 10

Pagesat e vonuara

1. Shoqëria administruese detyrohet t'i paguajë penaltitet në formë interesi anëtarit të fondit të pensionit në rastin e vonesave në pagimin e shumave të menjëhershme apo të pagesave periodike.
2. Shuma e interesit të pagueshëm tek anëtari i fondit për çdo pagesë të vonuar llogaritet duke marrë parasysh:
 - a. çdo ditë vonesë, duke filluar nga dita e parë e urdhërit për kryerjen e pagesës nga fondi, deri në ditën kur kryhet pagesa;
 - b. shumën e pagesës së vonuar.
3. Tarifa e penaltitetit për çdo ditë vonesë do llogaritet si raport i Yield i bonos së thesarit, 12 mujore të ankandit më të fundit plus 5% me 365 ditë.

Neni 11

Trashëgimia e aktiveve

Aktivet që mbeten në llogarinë e përfituesit të pensionit pas vdekjes së tij, trashëgohen në përputhje me legjislacionin në fuqi, që rregullon të drejtën e trashëgimisë.

Neni 12

Trajtimi fiskal i pagesave të marra nga anëtari

Pagesat e marra nga anëtari në mënyrë periodike mujore, në mënyrë të menjëhershme, apo nëpërmjet blerjes së një kontratë të sigurimit të jetës në formë “anuiteti” në një shoqëri sigurimi jete, do të tathohen sipas kreut XIII të ligjit, ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat në Republikën e Shqipërisë”, si dhe udhëzimit në zbatim të tij.

Neni 13

Dispozitë kalimtare

1. Shoqëritë administruese të fondeve të pensionit privat, brenda 3 muajve, nga hyrja në fuqi e kësaj rregullore hartojnë shtesë kontrate me anëtarët në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje.
2. Për kontratat e nënshkruara ndërmjet anëtarit të fondit të pensionit dhe shoqërisë administruese për marrjen e pensionit në formën e pagesave periodike mujore, para hyrjes në fuqi të kësaj rregullore, aplikohet tatimi mbi të ardhurat nga hyrja në fuqi e ligjit.

Neni 14

Shfuqizime

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, rregullorja nr. 126, datë 07.12.2010 “Mbi mënyrat, kushtet dhe procedurat e pagesave të pensionit vullnetar”, shfuqizohet.

Neni 15
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.